



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058214

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876154

KPPP.nr.1011/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Smart Project” SH.P.K., me NUI: 810177304, me seli në rr. “Ganimete Tërbeshi”, Nr. 26, në Prishtinë, kundër debitorit “B&V” SH.P.K., me NUI: 810115552, me seli në rr. “Magjistralja Prishtinë - Shkup”, km.10, në Graçanicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.254/23 të datës 31.05.2023 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “B&V” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.254/23 të datës 31.05.2023 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.254/23 të datës 31.05.2023 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi.
- III. URDHËROHET debitori “B&V” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 53,100.00 € (pesëdhjetë e tre mijë e njëqind euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Smart Project” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.254/23, i datës 31.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 07/22, të datës 26.04.2022; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajë kreditorit shumën prej 53,100.00 € me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e lëshimit të faturës, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin përmbartim ose përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar se të njëjtit nuk kanë legjitimitet në këtë procedurë përmbartimore, pasi që kreditori ka lidhur Kontratë për Revidim të Projektit “Kompleksi Hotelier me pikë karburanti”, me kompaninë “Real Estate Kosovo” SH.P.K., si dhe një aneks kontratë të lidhur me vonë, e që sipas tyre “Real Estate Kosovo” SH.P.K., ka pranuar obligimin financiar në vlerë prej 53,100.00 €, duke shtuar se në aneksin e lartcekur kreditori ka deklaruar më përgjegjësi morale dhe penale se këtu debitori nuk ka asnjë obligim financiar apo ligjor ndaj kreditorit në momentin e hyrjes në fuqi të aneks kontratës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi, të hedhen poshtë të gjitha veprimet e ndërmarra, si dhe të obligohet kreditori që t’i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori ka ushtruar përgjigjen në prapësim, në të cilën ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe i pa arsyetuar, duke shtuar se debitori në prapësim nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme, në të cilën mund të mbështet prapësimi, kështu duke konsideruar që urdhri përmbartimor është bërë sipas dokumenti të besueshëm, i cili i ka të gjitha elementet që të paraqitet si dokument i besueshëm. Më tutje, ka shtuar se pas shterjes së të gjitha mundësive, kreditori është detyruar të inicioj procedurë për përmbushje të dhunshme ndaj debitorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor, si dhe të detyrohet debitori që të përmbush të gjitha shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat

e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 07/22 të datës 26.04.2022, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 07/22, e datës 26.04.2022 i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se Fatura Nr. 07/22 e datës 26.04.2022, është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datën 25.05.2022, e cila vërtetohet nga Fletëkthesa e Postës e cila është nënshkruar nga ana e debitorit, me ç’rast gjykata ka vërtetuar faktin që debitori së bashku me faturën e lartcekur, ka pranuar edhe shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturimit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1011/23, datë 28.06.2024.

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.